Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1004

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NIKA PrO - Ing SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KOMUNA E KAMENICËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë, Topanicë, Koretin, Karaçevë, Busavatë, Hodonoc, Çerdhje në Kamenicë-Ritenderim" me numër të prokurimit KM653-23-11643-5-2-1, me 15/02/2024, mori:

Vendim

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE NIKA PrO - Ing SH.P.K. me nr. 2023/1004, e datës 11/12/2023, kurse vendimi i Komunës së Kamenicës i datës 17.11.2023, nga cilësia e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë, Topanicë, Koretin, Karaçevë, Busavatë, Hodonoc, Çerdhje në Kamenicë-Ritenderim" me numër të prokurimit KM653-23-11643-5-2-1, mbetet në fuqi.

II. Konfiskohet mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njejtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak, është konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e parapara me dispozitën e nenit 111 të LPP dhe e njëjta është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafi 1, të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të Ligjit të cituar, kurse ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën-paragrafi 26 të LPP. Prandaj e njëjta përfshihet nën juridiksionin e këtij Organi dhe i nënshtrohet procesit të shqyrtimit dhe vendosjes meritore në kuptim të kompetencave të parapara me dispozitën e nenit 105 të LPP

Nisur nga të lartcekurat e duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 të LPP, OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues me datë 18.12.2023 për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore sikurse kërkohet në kuptim të nenet 113 lidhur me nenin 114 të LPP. Lidhur me ketë, Ekspertit Shqyrtues ka dorëzuar Raportin me datë 01.01.2024, i cili i përmban të gjitha elementet e kërkuara në vështrim të dispozitave të cituara si më sipër dhe rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të aprovohet pjesërisht e bazuar;
- Të mbetet në fuqi vendimi i atakuar i autoritetit kontraktues;

Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar, me ç'rast ankuesi është pajtuar me raportin e cituar, kurse AK është deklaruar se nuk pajtohet. Njëherësh konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me shkresat komplete kësaj lënde sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj ka kushte që Paneli të vendos në mënyrë meritore përkitazi me ankesat e ushtruara në rastin konkret.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave* -

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 4 paragrafi 1, nën-paragrafin 75 të LPP, lidhur me nenin 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj mori në shqyrtim të shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë, sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në ketë rast Paneli mori në konsideratë dhe i administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK, raportin e ekspertit të cilat i analizoi dhe shqyrtoi, përmbledhur si në vijim:

Ankuesi ka pohuar se AK e ka shpallur fitues kompaninë me çmim më te shtrenjte se oferta e tij/sajë ne vlerën 6,548.72 €, duke shpjeguar se vendimi i atakuar i AK nga ky aspekt është në kundërshtim me dispozitën e nenit 1 të LPP dhe parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit të sanksionuara me dispozitën e nenit 6 të këtij ligji. Ankuesi ka pohuar më tej se me aktin e atakuar, AK ka vepruar në kundërshtim dhe me parimin e barazisë me arsyetimin se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar shpjegime plotësuese në kuptim të nenit 72 të LPP edhe përkundër faktit se oferta e ankuesit është me e lirë. Në pjesë të caktuara të ankesës, Ankuesi ka pohuar se pajtohet dhe/ose nuk pajtohet me mendimin e ekspertes, natyrisht në varësi të faktit se si janë

analizuar dhe shpjeguar pohimet e tija ankimore. Nga ana tjetër, Paneli vëren se aktin e atakuar të autoritetit kontraktues janë përfshirë të gjitha këto pohime ankimore dhe të njëjtat i janë nënshtruar procesit të rishqyrtimit sikurse kërkohet mes tjerash dhe me nenin 108/A të LPP.

Duke i analizuar pohimet ankimore të prezantuara shkurtimisht si më sipër, Paneli vëren se në raportin e ekspertit shqyrtues të gjitha ato janë analizuar në mënyrë profesionale dhe specifike, sikurse kërkohet me nenin 113 lidhur me nenin 114 të LPP duke e veçuar në ketë rast konstatimin e ekspertit se "sa i përket këtyre 3/tre pretendimeve të para [v.j. pa nevojë për ti përshkruar sërish] nuk janë pretendime ankimore, sepse nuk është paraqitur asnjë fakt apo provë konkrete, të cilat do të mund të shqyrtoheshin nga eksperti shqyrtues". Në fakt, pavarësisht nga mendimi i cituar si më sipër i ekspertit, Paneli vëren nga pikëpamja e pavarur e tij se vërtetë pohimet ankimore të radhitura si 3/tri pretendimet e para ankimore, karakterizohen me përshkrimin e dispozitave, duke i arsyetuar të gjitha ato me pohimin se oferta e ankuesit është më e lirë se ajo e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Përderisa në raportin e cituar si më sipër, eksperti shqyrtues ka konsideruar se pohimet ankimore [të identifikuara dhe/ose të radhitura si 4 dhe 5] janë të bazuara dhe/ose pjesërisht të bazuara, të cilat ju referohen kritereve të paraparë me dosjen e tenderit dhe atë lidhur me: a) inxhinierin e elektroteknikës; dhe b) dorëzimin e dokumenteve të tjera përfshirë certifikatat dhe marrëveshjet e punës të cilat kanë të bëjnë me stafin e certifikuar dhe dokument tjera përkitazi me pajisjet e kërkuara dhe listën e tyre. Në ketë rast duke i analizuar pohimet si më sipër, Paneli vëren se eksperti shqyrtues i ka konsideruar këto pretendime si të bazuar dhe pjesërisht të bazuara, kryesisht bazuar në faktin se autoriteti kontraktues ka mundur të kërkoj sqarime plotësuese në vështrim të nenit 72 të LPP, megjithëse pa ndonjë vërejtjeje substanciale, Paneli vëren se raporti i cituar i ta trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet ankimore në rastin konkret.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive i ka analizuar dhe të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe ka krijuar bindjen e pavarur të tij/saj se autoriteti kontraktues i ka analizuar, vlerësuar dhe krahasuar ofertat në pajtim me kriteret e parashikuar në dosjen e tenderit në vështrim të nenit 27 lidhur me nenin 28 dhe vendosur sikurse kërkohet me dispozitën e nenit 59 të LPP. Në fakt edhe në pohimet e ankuesit por edhe në raportin e ekspertit shqyrtues është theksuar se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 72, përkitazi me sqarimet shtesë. Mirëpo duke i analizuar me kujdes përveç pohimeve ankimore, po ashtu edhe aktet dhe veprimet e autoritetit kontraktues, Paneli konsideron se dispozita e nenit 72 të LPP nuk krijon një detyrim absolut që autoriteti kontraktues domosdo, në çdo rast dhe për çfarëdo ta zbatoj, sepse kërkimi i shpjegimeve, informatave dhe/ose i ndonjë shkresave të nevojshme bëhet në kontekstin e gjitha shkresave të dorëzuara në përmbajtjen e një oferte, të cilat paraprakisht përbejnë fakte të njohura për të gjitha palët pjesëmarrëse në një aktivitet të prokurimit dhe i nënshtrohet në vijim procesit të ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave dhe natyrisht gjykimit dhe vlerësimit të pavarur të autoritetit kontraktues në kontekstin e nenit 59 të LPP. Nga ky aspekt, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të kësaj dispozite kërkimi i informacioneve shtesë behet në kontekstin e kushteve dhe rrethanave te parapara qartë në paragrafin 3 te nenit 72 cituar "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive." Për më tepër edhe në dispozitën e nenit 17.3 të Rregullores për Prokurimin Publik ju shpjegohet palëve të interesuar se "Formulari për

dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare" prandaj në kontekstin e shpjegimeve si më sipër gjithnjë mbetet detyrim i palëve të interesuara që paraprakisht dhe në kohë të mjaftueshme ta dorëzojnë ofertën në harmoni me kërkesa eksplicite të DT. Në fakt paneli vëren se një qasje e tillë përsëritet nga një seri ankuesish mirëpo përderisa ofertuesit paraprakisht është i njohur me qëllimin kushtet dhe natyrën e një aktiviteti të prokurimit do të thotë se jo çdo herë dhe në çdo rrethanë mund të kërkohet nga AK aplikimi i nenit 72, përndryshe kjo atakon qasjen etike dhe profesionale të vetë operatorëve ekonomik, por njëherësh shkakton pa nevojë edhe prolongimin e një aktiviteti të prokurimit.

Po ashtu në pohimet ankimore dhe shkresat tjera te kësaj lende konstatohet se nuk është kontestues fakti se oferta e ankuesit është më e lirë në raport me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, në vlerën e cituar si më sipër. Mirëpo në kuptimin integral të nenit 60 të LPP dhe nga pikëpamja e këtij paneli, diferenca e vlerave ofertuese në rastin konkret nuk përbën detyrim absolut dhe kriter të vetëm për konstatimin e përgjegjshëm ose jo të një oferte, përderisa përgjegjshmëria e një ofertuesi në raport me kushtet e kërkuara të DT bëhet në kontekstin integral të ofertës së tij/saj lidhur me kapacitetin ekonomik, financiar, përshtatshmëritë profesionale e tjera, të cilat vetëm kur analizohen së bashku e promovojnë një ofertues konkret si të përgjegjshëm ose jo.

Megjithëse dy nga pretendimet ankimore në raportin e ekspertit shqyrtues janë konsideruar si të bazuara apo pjesërisht të bazuara, Paneli në këtë aspekt shpreh mendimin e pavarur të tij se ankesa në rastin konkret në tërësi duhet të kualifikohet si e pabazuar, kurse vendimi i atakuar i autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë, Topanicë, Koretin, Karaçevë, Busavatë, Hodonoc, Çerdhe në Kamenicë- Ri tenderim" me numër të prokurimit KM653-23-11643-5-2-1, nuk karakterizohet me ndonjë të metë dhe i njëjti mbetet në fuqi.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 dhe për pikën II është vendosur sipas nenit 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E KAMENICËS**
- OE - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: